



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. prot.

Datë . .2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET
E ANKIMIMIT**

Data: 14.10.2025

Drejtuar: BOE Glavenica shpk & B93 II shpk NIPT K17710805A & L52209050O

Adresa e perfaqesuesit: Fier Ballsh Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedure e Hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-59818-08-29-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Rehabilitim i hapsirave publike, trotuareve dhe rrugicave te qytetit,**
CPV CPV Punime per mirembajtjen e rrugeve 45233141-9

Kohezgjatja e kontrates 3 (tre) muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **03.09.2025**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike
Nr. 50 date 08.09.2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. RSM Company shpk

nr.biznesi 810802422

Vlera 24,795,908 (njetzet e kater milion e shtateqind e nentdhjetë e pese mijë nentqind e tete) lekë
pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Nika shpk**NIPT J76705047U**

Vlera 24,665,707.5 (njetzet e kater milion e gjashteqind e gjashtedhjetë e pese mijë e shtateqind e shtate pike pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. 2Z Konstruksion shpk**NIPT J63229466K**

Vlera 28,216,125 (njetzet e tete milion e dyqind e gjashtembedhjetë mijë e njetqind e njetzet e pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. BOE Glavenica & B93 II shpk**NIPT K17710805A & L52209050O**

(me perqindje bashkepunimi 72,04% & 27,96%)

Vlera 35,036,270.72 (tridhjetë e pese milion e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatedhjetë pike shtatedhjetë e dy) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. Ndertimi shpk**NIPT K11325002C**

Vlera 22,795,920 (njetzet e dy milion e shtateqind e nentedhjetë e pese mijë e nenteqind e njetzet) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. Viscons Group shpk**NIPT L96513208E**

Vlera 36,441,058.5 (tridhjetë e gjashtë milion e katerqind e dyzet e një mijë e pesedhjetë e tete pike pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. RSM COMPANY shpk**NR.BIZNES 810802422**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **“RSM Comapny”shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. - Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik ka paraqitur dy kontrata me objekt “Asfaltimi I rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, Faza II-të” dhe “Furnizim vendosje të materialeve për mirëmbajtje sheshesh dhe trotuaresh”. Nga shqyrtimi i secilës prej tyre rezulton se:

- Operaotri ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqërisë me RSM COMPANY) me NIPT L04803001U, ka paraqitur kontratën publike të realizuar nga shoqëria mëmë me objekt “Asfaltimi I rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, Faza II-të”, me Autoritet Kontraktor Ministria e infrastrukturës, kontratë nr. 48/2016 lidhur me datë 28.09.2016.

Referuar “Procesverbalit të pranimit teknik dhe llogarisë përfundimtare të punëve të kryera, në projektin me objekt Asfaltimi I rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, Faza II-të”, pikës 4.1 citohet ndër të tjera se “Data e mbarimit të punëve është më 03.06.2020”.

Nisur nga këto të dhëna, referuar kërkesës së Autoritetit Kontraktor, që punë të ngjashme duhet të jenë realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (data e shpalljes së kontratës është 03.09.2025), kjo kontratë është më e vjetër se 5 (pesë) vite dhe për këtë arsye dokumenti është i pavlefshëm për të përmbushur kërkesën e pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik.

- Operaotri ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (dega e shoqërisë me RSM COMPANY) me NIPT L04803001U, ka paraqitur kontratën me objekt “Furnizim vendosje të materialeve për mirëmbajtje sheshesh dhe trotuaresh”, me Autoritet Kontraktor Bashkia Kavaje, kontratë nr. 3671/4 lidhur me datë 06.09.2024.

Nisur nga të dhënat e vetë kontratës apo të dhënat e vetë Autoritetit Kontraktor, theksomë se kontrata në fjalë është kontratë furnizimi i mallrave dhe jo një kontratë publike për realizimin e punëve. Kjo e bën këtë dokumenti të pavlefshëm për të përmbushur kërkesën e pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të perfshihet kesti për periudhën perkatese të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik aktualisht ka kontratë për realizimin e punëve publike me Bashkinë Kavajë, për të cilën nuk ka regjistruar në QKB adresën e ushtrimit të aktivitetit në vende të tjera dhe nuk ka shlyer detyrimet vendore pranë Bashkisë Kavajë.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i operatorit ekonomik ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen, si të papranueshme

2. Nika shpk

NIPT J76705047U

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “**Nika**”shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të perfshihet kasti për periudhën perkatese të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar, citohet se janë shtuar adresat si më poshtë:

- Më datë 10.02.2025 është Shtuar Adresa: është Shtuar Adresa: "Korce; KORÇE; Korçe; ; KORCE; KORCE,Korce,Korce,"Rruga Loni Llogori ,Korce(me objekt: “ ”Investime në Ujesjellesin në fshatrat Sheqeras, Plase, Libonik,etj,)Ujesjelles Kanalizime Korce.;

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik Nika shpk ka paraqitur 4 (katër) vërtetime të pagesave të taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Korçë. Konkretisht vërtetim nr.5781prot datë 15.07.2024, I cili vërteton pagesën e taksave për vitin 2024; vërtetim nr.35prot datë 06.01.2025, I cili gjithashtu vërteton pagesën e taksave për vitin 2024; vërtetim nr.1075prot datë 11.02.2025, I cili vërteton pagesën e taksave për vitin 2024 dhe vërtetim nr.5226prot datë 24.06.2025, I cili vërteton pagesën e taksave deri më datë 31.01.2025.

Vërtetimet e paraqitura nga operatori ekonomik nuk vërtetojnë pagesën e taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Korçë pas datës 10.02.2025, datë e regjistrimit të adresë së mësipërme për ushtrimin e aktivitetit përkatës.

- Më datë 10.02.2025 është Shtuar Adresa: Elbasan Mirembajtje e objekteve ndërtimore dhe mjedise të jashtme” Universiteti “Aleksander Xhuvani
- Më datë 10.02.2025 është Shtuar Adresa M. e Madhe Ura lidhese për fshatrat Vermosh -Velan – Velipoj

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik Nika shpk nuk ka paraqitur dokument që vërteton pagesat e taksave vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe dhe Bashkisë Elbasan.

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponibilitetin e stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 4 (katër) punonjës me profesion pllakashtrues dhe për 4 (katër) manovratorë/eskavatoristë, për të cilët duhet të jetë lidhur kontratë pune dhe të jenë të certifikuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme. Gjithashtu Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Maj - Korrik 2025.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi ka deklaruar ndër të tjera punonjës A.N. (me numër rëndor 18) si pllakashtrues. Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, është paraqitur kontratë pune me punonjesin A. N. duke mos specifikuar profesionin e tij dhe nuk është paraqitur gjithashtu certifikatë nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi ka deklaruar ndër të tjera punonjës B. N. (me numër rëndor 30) si manovrator. Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, është paraqitur kontratë pune me punonjesin B. N. duke mos specifikuar profesionin e tij, certifikatë e aftësisë profesionale “C” “CE” dhe leje drejtimi “B” “C”. Asnjëra nga këto dokumente nuk vërteton se punonjësi B. N. është manovrator/eskavatorist.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponibilitetin e mjetet e pajisjet teknike, që operatori ekonomik ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratë noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, certifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, për mjetet:

- 1 (një) kamionë me kapacitet mbajtës ≥ 20 ton;
- 3 (tre) kamionë me kapacitet mbajtës 10 - 18 ton;
- 2 (dy) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton;
- 1 (një) autovinc ± 2.5 ton;
- 1 (një) autobot uji;
- Etj.

është paraqitur si dokumentacion provues vetëm leja e qarkullimit dhe në dy raste bashkë me lejen e qarkullimit edhe certifikata e pronësisë së mjetit.

4. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën “e” të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit për pagesën e energjisë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga operatori ekonomik, rezulton se, është paraqitur Vërtim Debie I lëshuar më datë 25.07.2025. Duke marrë parasysh faktin që data e publikimit të procedurës është 03.09.2025 dhe afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është 18.09.2025, operatori ekonomik duhet të kishte përfshirë në pagesat e energjisë elektrike edhe pagesën e muajit Korrik 2025, detyrim që paguhet brenda datë 31.08.2025.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i operatorit ekonomik ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen, si të papranueshme.

3. 2Z Konstruksion shpk

NIPT J63229466K

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “**2Z Konstruksion ”shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Bazuar në përcaktimin e nenit 82, të LPP-së, pika 2 në të cilin thuhet “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.” dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021 pika 7 në të cilin thuhet “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar nga operatori ekonomik të paraqesë dokumentacion provues për pikat 2.2.3; 2.3.4 pikat 2 dhe 6; 2.3.5 dhe 2.3.6 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Afati I dorëzimit të dokumentacionit është data 25.09.2025 ora 12:00. Operatori ekonomik nuk ka arritur të dorëzojë

dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Dokumentacioni I kërkuar është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar.

Pavarësisht nga sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe dokumentacionit provues janë konstatuar mangësitë si më poshtë:

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të perfshihet kesti për periudhën perkatese të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar, citohet se më datë 10.02.2025 është Shtuar Adresa: "Lezhe; LAC; Lac; ; LAC; Qender Gorre 03290072; Nderresa 13;" dhe hequr më datë 28.07.2025. Operatori ekonomik bashkë me dokumentacionin provues të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor ka paraqitur vërtetime të pagesave të taksave vendore, ndër të cilat nuk rezultojnë të ketë vërtetim për pagesën e taksave vendore në Bashkinë Laç.

3. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponibilitetin e stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 2 (dy) punonjës me profesion bojaxhi dhe 2 (dy) punonjës për konstruksione për të cilën duhet të jetë lidhur kontratë pune dhe të jenë të certifikuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme. Gjithashtu Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Maj - Korrik 2025.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon stafin teknik sikundër përcaktuar në pikën 2.3.4.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës me profesion bojaxhinj. Gjithashtu, ofertuesi ka deklaruar se disponon vetëm punonjesin **A. Z.** nga 2 (dy) punonjës për konstruksione të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

4. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponibilitetin e mjetet e pajisjet teknike, që operatori ekonomik ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 2 (dy) eskavator me goma dhe 1 (një) vinc kullë (shoqëruar me skedë teknike).

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin C DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi nuk ka deklaruar se mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë sikundër përcaktuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik, duke mos deklaruar se disponon 2 (dy) eskavator me goma. Konkretisht, ofertuesi ka deklaruar se disponon vetëm 1 (një) eskavator me goma me targë A....5 nga 2 (dy) të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Gjithashtu, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit në Seksionin C DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate” ofertuesi ka deklaruar se disponon 1 (një) vinc, pa specifikuar llojin përkatës të tij.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i operatorit ekonomik ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen, si të papranueshme.

4. Ndertimi shpk

NIPT K11325002C

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **“Ndertimi” shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Bazuar në përcaktimin e nenit 82, të LPP-së, pika 2 në të cilin thuhet “Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.” dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021 pika 7 në të cilin thuhet “Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar nga operatori ekonomik të paraqesë dokumentacion provues për pikat 2.3.4 pikat 2 dhe 6; 2.3.5 dhe 2.3.6 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Afati I dorëzimit të dokumentacionit është data 25.09.2025 ora 12:00. Operatori ekonomik nuk ka arritur të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Pavarësisht nga sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE janë konstatuar mangësitë si më poshtë:

2. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën “c” të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit ofruesi deklaron se nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik Ndertimi shpk konstatohet se në Seksionin B DEKLARATE “Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik” në pikën “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” është deklaruar se do të mbështetet edhe në kapacitetet e subjektit NORD COMAT shpk konkretisht me 1(një) inxhinier agrar dhe 13(trembëdhjetë) punonjës.

Në Shtojcën 8 të DST me të njëjtin objekt është përcaktuar se “Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.”.

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit ekonomik NORD COMAT shpk konstatohet se në seksionin Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT pika A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT është deklaruar se “Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: **E. Ç.** Me të dhënat përkatëse etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Ndërkohë po ti referohemi Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të shoqërisë NORD COMAT shpk rezulton se shoqëria ka dy ortakë me pjesëmarrje në përqindje 50 (%) ortaku **E. Ç.** dhe 50 (%) **A.G.** I cili është gjithashtu administrator i shoqërisë.

Në Shtojcën 8 të DST me të njëjtin objekt është përcaktuar gjithashtu se “Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.”

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i operatorit ekonomik ofertues, të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen, si të papranueshme

- ” OE nuk ka ngarkuar në SPE punët e ngjashme duke mos plotësuar kete kusht

5. Viscons Group shpk

NIPT L96513208E

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “**Viscons Group**”shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik ka paraqitur sigurimin e kontrates per proceduren e prokurimit
2. Operatori ekonomik nuk permbush punet e ngjashme ne perqindjen e kerkuar
3. Operatori ekonomik nuk ka deklaruar kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024
4. Operatori ekonomik ka deklaruar ne formular vetdeklarimi punetori 20-21 jo aq sa eshte kerkuar nga AK konkretisht 61
- 5.Operatori ekonomik nuk ka deklaruar ne formular vetdeklarimi per inxhinier mjedisi dhe hidroteknik
6. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatat ISO te kerkuara nga AK

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, BOE **Glavenica shpk & B93 II shpk** NIPT K17710805A & L52209050O, me adrese te perfaqesuesit Fier Ballsh BALLSH Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 35,036,270.72 (tridhjetë e pese milion e tridhjetë e gjashte mije e dyqind e shtatedhjetë pike shtatedhjetë e dy) lekë pa tvshështë identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.